

Mars 2020

# SONDAZH I MËSIMIT ONLINE

Perceptime të nxënësve, prindërve dhe mësuesve



**HYRJJE**

Situata e krijuar me pandeminë COVID-19 ka detyruar Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) të mbyllë të gjitha institucionet arsimore nga data 9 mars 2020, për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të virusit dhe për të mbrojtur shëndetin e të gjithë qytetarëve. Fillimisht institucionet arsimore u mbyllën për një periudhë dyjavore, pastaj kjo periudhë u shty edhe me dy javë shtesë. Në momentin e shkrimit të këtij teksti, nuk dihet ende nëse shkollat do të hapen me 6 prill 2020 apo do të qëndrojnë të mbyllura për periudhë më të gjatë kohore.

Në mënyrë që nxënësit të mos mbeten prapa me mësim dhe të krijohet mundësia për përfundimin e vitit shkollor, MASR në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), e kanë kaluar gjithë procesin mësimor nga shkolla tek mësimi në kushte shtëpie. Dy forma kryesore mësimore po aplikohen: leksione të xhiruara dhe të transmetuara në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH) dhe puna mes nxënësve dhe mësuesve përmes rrjeteve sociale apo platformave të ndryshme që mundësojnë krijimin e klasave virtuale (si google classroom, zoom, edomondo etj).

Për të vlerësuar angazhimin e palëve në këtë proces, efektshmërinë e tij, si dhe mënyrat për përmirësimin e zbatimit të tij, ASCAP ka hartuar dhe përmes DPAP-së ka administruar një sondazh me mësues, nxënës dhe prindër , për mësimin online. Sondazhi është administruar online dhe ka qenë i hapur për një periudhë 4- ditore.

Falënderojmë 321 911 nxënësit, prindërit dhe mësuesit që ndanë kohën e tyre dhe morën pjesë në këtë sondazh të rëndësishëm për mbarëvajtjen e mësimit në kushtet e shtëpisë.

Në kushtet e mbylljes së shkollave, mësuesit po zbatojnë mënyra të reja të procesit të mësimdhënies, nxënësit po përballen me mënyra të reja të nxënies, si dhe shumë prindër po e gjejnë veten me një titull të ri, të papritur dhe sfidues “Mësues”.

Nga njëra anë, situata e krijuar nga COVID-19 ka ndërgjegjësuar të gjithë qytetarët, por mbi të gjitha bashkëpunimi mësues – prindër – nxënës në këtë situatë po merr një përmasë më të madhe. Procesi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet këtij trinomi nëpërmjet rrjeteve sociale, platformave të ndryshme online është më i miri i mundshëm që mund të realizohet në këto kushte, në mënyrë që fëmijët të vijojnë me realizimin e njohurive dhe të aftësive që kërkon kurrikula.

Nga ana tjetër, prindërit nuk janë mësues dhe mund të ndjehen të mbingarkuar nga presioni për t'i ndihmuar fëmijët e tyre që të përvetësojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme gjatë kohës që shkollat janë mbyllur, por megjithatë në këto momente klasa virtuale dhe komunikimi online me mësuesit dhe shokët e tyre është mënyra e vetme për të vijuar me procesin e mësimit.

Në këtë kontekst, sondazhi ka synuar:

- të vlerësojë efektivitetin e mësimit në kushtet e shtëpisë dhe të formave të zhvilluara nga mësuesit, parë kjo nga këndvështrimi i nxënësve, prindërve dhe mësuesve;
- të evidentojë përvoja pozitive dhe të bëjë shpërndarjen e këtyre përvojave;
- të orientojë vendimmarrje që mbështeten në të dhëna;
- të nxitë dialogun mes nxënësve, prindërve dhe mësuesve, me qëllim përmirësimin e mësimit në kushtet e shtëpisë.

# ANALIZA E GJETJEVE

Një numër i madh nxënësish, prindërisht dhe mësuesish morën pjesë në këtë sondazh. Bazuar në të dhënat e pyetësorëve rezultoi se në sondazh morën pjesë:

- 178 096 nxënës;
- 118 376 prindër;
- 25 439 mësues.

Në total për të tre instrumentet janë përfshirë 321 911 persona. Është e rëndësishme të nënvizohet se sondazhi është administruar tek mësuesit, nxënësit dhe prindërit e nxënësve të klasave 1-12, kryesisht në arsimin publik (me disa përgjigje nga mësues dhe nxënës të arsimit privat parauniversitar). Sondazhi NUK është aplikuar tek arsimit parashkollor dhe arsimit profesional.

Nga analiza e gjetjeve kryesore, ajo që vihet re dhe që përputhet me informacionin që MASR e merr çdo ditë nga DPAP, për përfshirjen e mësuesve dhe të nxënësve në procesin mësimor, është se një numër i konsiderueshëm i nxënësve, prindërve dhe mësuesve janë angazhuar në mësimet online: 96.8% e nxënësve, 95.3% e prindërve dhe 98.7% e mësuesve.

Mësimet e transmetuara në programin televiziv “RTSH Shkolla” ndiqen nga pjesa më e madhe e nxënësve, prindërve dhe mësuesve: 84.1% e nxënësve, 85% e prindërve dhe 96.5% e mësuesve. Ata që nuk kanë arritur të shohin transmetimet, i aksesojnë videot te kanali Youtube i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë (54.2% e nxënësve) apo edhe tek platforma akademi.al (64.2% e nxënësve).

Kalimi nga shkolla te mësimi në kushte shtëpie, gjatë dy javëve të para është pritur mirë nga nxënësit dhe prindërit. Rreth 86.4% e nxënësve shprehen se janë dakord dhe shumë dakord për të marrë mësimet përmes komunikimit online dhe 90.2% e prindërve shprehen dakord dhe shumë dakord që janë pjesë e grupeve të komunikimit online me mësuesit. Mësimi online në kushtet e shtëpisë, me gjithë mbingarkesën e prindërve, ka forcuar më shumë partneritetin nxënës – prindër – mësues duke i dhënë më shumë mundësi prindërve të marrin pjesë në procesin e të nxënësve të tyre.

Mësimi online në kushtet e shtëpisë, megjithëse nuk mund ta zëvendësojë mësimin në klasë, ka krijuar mundësi që nxënësit të punojnë dhe të krijojnë të pavarur në kushtet e shtëpisë duke përdorur burime digjitale alternative. Sot nxënësit rriten me teknologji dhe ky burim është lehtësisht i përdorshëm për ta. 77.4% e prindërve pohojnë se fëmijët e tyre po zhvillojnë kompetencën digjitale duke aplikuar mësimin online.

Gjatë kësaj periudhe shumica e nxënësve, jo vetëm që kanë bërë përsëritje dhe përforcim të koncepteve të mësuara, por kanë mësuar edhe koncepte të reja (84.7% e mësuesve dhe 81.5% e nxënësve e pohojnë këtë), gjë që tregon se angazhimi i madh i mësuesve, prindërve dhe nxënësve ka arritur të zëvendësojë sadopak mësimin që ndodh në shkolla. Rreth 43.6% e prindërve deklarojnë se ky lloj të mësuari ka të njëjtën cilësi si procesi mësimor në klasë, ndërkohë që 32.2% janë pjesërisht dakord dhe 14.4% nuk janë dakord. Nga ana tjetër perceptimi i mësuesve për efektivitetin e mësimit online rezulton të jetë afërsisht në përputhje me perceptimin e prindërve, pasi 37.8% e mësuesve shprehen se mësimi online është i të njëjtës cilësi sikurse mësimi në shkollë, ndërsa 36% e mësuesve janë pjesërisht dakord me këtë pohim.

Gjithashtu pjesë e mësimit online në kushtet e shtëpisë ka qenë edhe vlerësimi i nxënësit, si një nga komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës. Nga të dhënat e grumbulluara rezulton se 91.4% e nxënësve shprehen shumë dakord dhe dakord se vlerësohen nga mësuesit për detyrat dhe ushtrimet e kryera dhe nga ana tjetër 91.2 e mësuesve shprehen se kanë bërë vlerësime të nxënësve për detyrat e shtëpisë, punë të pavarur etj.

Lidhur me realizmin e detyrave rezulton se 83.6% e nxënësve pohojnë se mund t'i përfundojnë detyrat gjatë mësimeve të zhvilluara përmes komunikimit online dhe se 74.5% e nxënësve kanë më shumë mundësi të punojnë në mënyrë të pavarur.

Në këtë situatë partneriteti mësues – prindër – nxënës merr një rëndësi tepër të veçantë për ta bërë këtë proces sa më efektiv. Ata kanë krijuar komunikime dhe këtë e dëshmojnë të dhënat e grumbulluara. Nga njëra anë rreth 93.9% e prindërve marrin çdo informacion që vjen nga drejtoria e shkollës dhe mësuesit e fëmijës së tyre dhe i mbështesin ata duke lehtësuar marrjen e informacionit, nga ana tjetër 95.7% e mësuesve shprehen se komunikojnë rregullisht me prindërit dhe nxënësit për shpërndarjen e informacionit.

Ndërveprimi mes mësuesve dhe nxënësve është shumë i rëndësishëm në procesin mësimor pasi që inkurajon të mësuarin. Kjo është arritur në masë të madhe gjatë mësimit online: 89.8% e nxënësve dhe 93.7% e mësuesve pohojnë se gjatë ditës së punës online drejtohen pyetje dhe merren përgjigje nga ndërveprimi mësues – nxënës për paqartësi dhe vështirësi në temat mësimore.



Mësuesit kanë zbatuar udhëzimet që gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë të balancojnë përsëritjen e njohurive të fituara më parë dhe përvetësimin e njohurive të reja. Ata janë treguar fleksibël duke përshtatur planifikimin e temave mësimore (81.5% e nxënësve, 76.9% e prindërve dhe 84.7% e mësuesve e mbështesin këtë gjë). Gjithashtu në këtë kontekst 95.1% e mësuesve shprehen dakord dhe shumë dakord se e shohin me përparësi ngarkesën e përmbajtjes mësimore që trajtojnë më nxënësit.

Mësimi online në kushtet e shtëpisë, me gjithë vështirësitë, ka krijuar mundësi që mësuesit të përdorin më shumë burime digjitale alternative për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë e kërkuara nga kurrikula me kompetenca. 74.1% e mësuesve shprehen dakord që u pëlqen shumë ndërveprimi në formë elektronike, madje 88.7% e mësuesve përdorin video-selfie për të përcaktuar përmbajtjet mësimore. Nga rezultatet e grumbulluara 84.1% e mësuesve shprehen se kanë shpërndarë me nxënësit dhe me kolegët e tyre video, powerpoint etj.

Përkundër eksplorimit të platformave për klasë virtuale që mësuesit po bëjnë në këtë kohë (68.1% pohojnë se përdornin platforma të ndryshme online), WhatsApp mbetet komunikimi online më i përdorur nga mësuesit, me 96.4% e tyre.

Mësimi online në kushtet e shtëpisë i ka bërë mësuesit të ndjekin më shumë platforma trajnimi online duke zhvilluar kapacitetet e tyre profesionale në këtë fushë. Trajnimi i mësuesve në zhvillimin e kompetencave digjitale nga njëra anë ka qenë një nga fushat më prioritare për të zhvilluar shkollat e shekullit XXI, por nga ana tjetër është pjesa më e vështirë për mësuesit.

Mësimi digjital është e ardhmja për shkollat e shekullit XXI dhe me gjithë përballjen e menjëhershme të mësuesve me këtë lloj mësimi, do të shërbejë në të ardhmen si burim i rëndësishëm i procesit të të nxënës.

# Metodologjia



## Kampionimi

- Kampioni i qellimshëm
- Nxënës, prindër dhe mësues
- 61 Bashki



## Instrumentet

- 3 instrumente
- Instrumenti parë - 16 pohime
- Instrumenti dytë - 14 pohime
- Instrumenti tretë - 27 pohime



## Mbledhja dhe analiza e të dhënave

- Mbledhja në googleforms
- Përpunimi në SPSS

## Pjesëmarrja për çdo ZVAP

Tiranë	67648
Elbasan	22322
Durrës	21565
Fier	17399
Dibër	13183

## Pjesëmarrja për çdo DRAP

Durrës	139195
Korçë	73500
Fier	61929
Lezhë	39871


**Kampioni total**

**321911**

**Nxënës**  
**178096**


**Prindër**  
**118376**

**Mësues**  
**25439**




■ Nxënës (55.32%)
 ■ Prindër (36.77%)
 ■ Mësues (7.9%)

Shpërndarja sipas qarqeve




Population



Shpërndarja sipas DRAP




Population




# PERCEPTIMET E NXËNËSVE


## Zona ku ndodhet shkolla e nxënësit



## Gjinia e nxënësve




## Klasa a nxënësve




# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online

■ A jeni angazhuar ju si nxënës në mësime online?  
■ Po ■ JO



■ A i keni ndjekur materialet audiovizive të transmetuara në programin televiziv “RTSH Shkolla”?  
■ Po ■ JO




■ A e ndiqni kanalin Youtube te MASR?  
■ Po ■ JO



■ A e ndiqni platformën akademi.al për te pare video mësimore?  
■ Po ■ JO




# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online



Unë mund të hyj dhe të komunikoj lehtësisht, për të marrë mësimet përmes komunikimit online.




# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online




Unë mund të komunikoj në mënyrë aktive me shokët e mi të klasës dhe me mësuesit, në formë elektronike.

# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online




Gjatë mësimit online, unë jam në gjendje të menaxhoj kohën time të studimit në mënyrë efektive dhe të mbaroj detyrat.

# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online




Si nxënës, mësimi online më pëlqen sepse kam më shumë mundësi të punoj në mënyrë të pavarur.

# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online




Më pëlqen ndërveprimi me mësuesit dhe shokët e mi të klasës, në formë elektronike.

# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online




Unë mund të bashkëpunoj, diskutoj dhe punoj në grup me shokët e mi të klasës, gjatë veprimtarive të mësimit online.

# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online




Unë angazhohem maksimalisht për kryerjen e detyrave të dhëna nga mësuesit e mi, gjatë mësimit online.

# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online



Unë u drejtoj pyetje mësuesve të mi dhe marr përgjigje të shpejtë nga ata, për vështirësitë dhe paqartësitë që kam në lidhje me temat mësimore.


# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online



Unë ndjek video dhe mësim online që më sugjerohen nga mësuesit e mi.




# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online




Unë dërgoj detyra/ushtime/punime të ndryshme të kryera prej meje gjatë periudhës së qëndrimit në shtëpi, për të marrë komente nga mësuesi dhe nxënësit e tjerë.

# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online




Gjatë procesit mësimor online unë jo vetëm që kam përsëritur njohuritë e fituara më parë, por kam përvetësuar edhe njohuri të reja.

# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online



**Unë vlerësohem nga mësuesit e mi,  
për detyrat ose ushtrimet që kryej.**


# Përgjigjet e nxënësve në lidhje me mësimin online



Videot e transmetuara në RTSH Shkolla më kanë ndihmuar gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë.

# PERCEPTIMET E PRINDËRVE

### Zona ku ndodhet shkolla e fëmijës




Fshat (65.96%)    Qytet (34.04%)

### Gjinia e prindërve




Femër (26.73%)    Mashkull (73.27%)


### Statusi i punësimit të prindërve



### Arsimi i prindërve




### Statusi i gjendjes civile të prindërve



# Përgjigjet e prindërve në lidhje me mësimin online

■ A jeni angazhuar ju si prind në mësime online me fëmijën tuaj?

■ Po ■ JO




■ A i ka parë fëmija juaj materialet audiovizive të transmetuara në programin televiziv “RTSH Shkolla”?

■ Po ■ JO




■ A jeni ju ose fëmijët tuaj, në grup online me mësuesit sipas profilit ose lëndëve përkatëse?

■ Po ■ JO






# Përgjigjet e prindërve në lidhje me mësimin online




Unë jam pjesë e grupeve të komunikimit me mësuesit, sipas planit të përcaktuar nga drejtoria e shkollës.

# Përgjigjet e prindërve në lidhje me mësimin online




Unë marr çdo informacion dhe jam në dijeni për çdo gjë që vjen nga drejtoria e shkollës dhe nga mësuesit e fëmijës tim.

# Përgjigjet e prindërve në lidhje me mësimin online




Gjatë qëndrimit në shtëpi të fëmijës tim, unë si prind e mbështes atë në mësimin në kushtet e shtëpisë, duke lehtësuar marrjen e informacionit nga mësuesit.

# Përgjigjet e prindërve në lidhje me mësimin online




Të mësuarit online ndihmon fëmijën tim për zhvillimin e kompetencës digjitale.

# Përgjigjet e prindërve në lidhje me mësimin online




Të mësuarit online ka të njëjtën cilësi si procesi mësimor në klasë.

# Përgjigjet e prindërve në lidhje me mësimin online




Të mësuarit në mënyrë elektronike ndikon në zhvillimin personal dhe social të fëmijës tim.

# Përgjigjet e prindërve në lidhje me mësimin online



Fëmija im angazhohet maksimalisht për kryerjen e detyrave të dhëna nga mësuesit e tij.


# Përgjigjet e prindërve në lidhje me mësimin online



Fëmija im punon në grup gjatë aktiviteteve të mësimit online.




# Përgjigjet e prindërve në lidhje me mësimin online




Gjatë mësimit online, fëmija im mund të bëjë pyetje për mësuesin e tij dhe të marrë një përgjigje të shpejtë gjatë aktiviteteve mësimore.

# Përgjigjet e prindërve në lidhje me mësimin online



Gjatë mësimit online, fëmija im jo vetëm që ka përsëritur njohuritë e fituara më parë, por edhe ka përvetësuar njohuri të reja.


# Përgjigjet e prindërve në lidhje me mësimin online




Gjatë mësimit online, fëmija im merr vlerësime ose komente nga mësuesit për detyrat ose ushtrimet që kryen.

# PERCEPTIMET E MËSUESVE


### Zona ku ndodhet shkolla ku jep mësim



### Gjinia e mësuesve




### Cikli ku jep mësim




# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online


■ A jeni angazhuar ju si mësues në mësime online?  
■ Po ■ JO




■ A i keni parë materialet audiovizive të transmetuara në programin televiziv “RTSH Shkolla”?  
■ Po ■ JO



■ A e ndiqni kanalin Youtube te MASR?  
■ Po ■ JO




■ A e ndiqni platformën akademi.al për te pare video mësimore?  
■ Po ■ JO




# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online

A përdorni me nxënësit tuaj për komunikimin e përmbajtjeve/temave mësimore?

Po Jo




# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online



**Më pëlqen shumë ndërveprimi me nxënësit në formë elektronike.**




# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online




U adresoj pyetje nxënësve të mi për vështirësitë dhe paqartësitë që mund të kenë në lidhje me përmbajtjet/temat mësimore e rekomanduara.

# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online




Komunikoj rregullisht me nxënësit, prindërit e tyre dhe me drejtuesit e institucionit arsimor që nxënësit të jenë të angazhuar për mësimet në kushtet e shtëpisë.

# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online




Përcaktoj përmbajtje mësimore (video-selfie) dhe ua rekomandoj nxënësve duke respektuar planin mësimor të lëndës për klasën përkatëse.

# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online




Jap udhëzime në grupin e krijuar, në lidhje me përvetësimin e përmbajtjes mësimore nëpërmjet mesazheve dhe videove të përgatitura.

# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online




Iu përgjigjem pyetjeve që adresojnë nxënësit në lidhje me përmbajtjen/temat mësimore.

# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online




Shoh me përparësi ngarkesën e nxënësit me përmbajtjen mësimore, duke u fokusuar në njohuritë kryesore të reja dhe në përforcimin e njohurive të fituara deri tani.

# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online



Informoj drejtorinë e shkollës lidhur me ecurinë e zhvillimit të mësimit në kushtet e shtëpisë.


# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online



Aktivitetet/videot/audiot në internet bazohen në tekstin shkollor dhe programin lëndor.




# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online




Mësimi efektiv mund të zhvillohet edhe pa ndërvepruar me nxënësit e mi ballë për ballë.

# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online




Jam fleksibël në trajtimin e nevojave të nxënësve të mi, gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë.

# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online




Jam i kënaqur me angazhimin e nxënësve të mi gjatë procesit të mësimit online dhe i vlerësoj me fjalë dhe komente ata, në mënyrë që t'i motivoj për të nxënë.

# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online




Jam i gatshëm të investoj një sasi të konsiderueshme kohe dhe energjie në përgatitjen e mësimdhënies online.

# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online



Jap detyra, ushtrime, lexime plotësuese, kuizze etj. për përmbajtjen/temën mësimore, në varësi të specifikave të lëndës time.


# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online




Gjatë mësimit online, nxënësit e mi jo vetëm kanë përsëritur njohuritë e fituara më parë, por kanë përvetësuar edhe njohuri të reja.

# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online

Mësimi online i mundëson fëmijëve të ndajnë shqetësime, probleme, nevoja, diskutime që nuk kanë të bëjnë vetëm me të mësuarin, por dhe me çështje të tjera që ndikojnë në aspektin social-emocional të nxënësve (mirëqenien psiko-emocionale të fëmijëve).




# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online



Kam përgatitur video, powerpoint, etj. për ore mësimore dhe i kam shpërndarë ato me nxënësit dhe kolegët.



# Përgjigjet e mësuesve në lidhje me mësimin online



Kam bërë vlerësime të nxënësit për detyra të shtëpisë, punë të pavarur, etj.

## Sondazhi i mësimit online



[www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al)  
[www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al)

